



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT K R Y E T A R I

Nr.729/6Prot.

Tiranë, më 19 /12/2016

### V E N D I M

**Nr. 147, Datë 19/12/2016**

#### P Ë R

**EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E PREFEKTIT TË QARKUT KORÇË “MBI ZBATIMIN E LIGJSHMËRISË DHE RREGULLSHMËRISË FINANCIARE” PËR PERIUDHEN 01.01.2013 DERI 30.06.2016.**

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projekt vendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Drejtorisë Juridike, Sigurimit të Standardeve dhe Etikës, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Auditimit të mësipërm, dhe mendimin e Drejtorit të Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, dhe 30, të ligjit nr. 154, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

### V E N D O S A:

**I.** Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “Për auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë të aktivitetit ekonomik dhe financiarë” të ushtruar në Institucionin e Prefektit të Qarkut Korçë, për periudhën 01.01.2013 deri më 30.06.2016.

**II.** Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

#### **A. MASA ORGANIZATIVE**

**1 - Gjetje nga auditimi:** Nga 4 masa organizative të lëna nga KLSH, janë zbatuar **3 masa** dhe është në proces zbatimi një masë për arkëtim e shumës **36,421 lekë** nga M.M. dhe shumën **20,000 lekë** nga “R K”.

**1.1 - Rekomandimi:** Sektori i Financës të marrë masa, të ndjek në rrugë ligjore dhe administrative arkëtimin e shumës **36,421 lekë** nga M.M. dhe në shumën **20,000 lekë** nga “R K”.

**Menjëherë**

**2 - Gjetje nga auditimi:** Sektori i Financës pranë Institucionit të Prefekti të Qarkut Korçë, në lidhje me inventarizimin e pronës shtetërore për vitin 2013, 2014, 2015 **nuk ka hartuar një program vjetor** me synim sigurimin para dhe gjatë kryerjes së inventarizimit të pronës shtetërore. Materialet drusore dhe me përbërje metali **me vlerë 707,460 lekë**, nuk janë bërë hyrje në magazinë si materiale jashtë përdorimit, veprim në papajtueshmëri me pikën 17, 18, 103 dhe 108, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësinë e sektorit publik”, të ndryshuar, me UMB nr. 1151, datë 16.07.2007 “Për kriteret dhe procedurat e vlerësimit dhe asgjësimit të aktiveve të qëndrueshme dhe qarkulluese në sistemin e Ministrisë Brendshme”.

**2.1 - Rekomandimi:** Sektori i Financës pranë Institucionit të Prefekti të Qarkut Korçë të marrë masa, të hartoj program vjetor pune për inventarizimin e pronës shtetërore, ndërsa materiale jashtë përdorimit të bëhen hyrje në magazinë.

#### Në vijimësi

**3 - Gjetje nga auditimi:** Në Institucionin e Prefektit të Qarkut Korçë, komisioni i asgjësimit, **materialet nuk i ka marrë me fletë dalje nga magazina.** Materialet e asgjësuar me përbërje druri nuk i ka kthyer në lëndë drusore dhe nuk i ka bërë hyrje në magazinë si dru zjarri, si dhe materialet me përbërje metali nuk i ka bërë hyrje në magazinë dhe nuk i ka shitur si skrap nëpërmjet ankandit publik, veprim në papajtueshmëri me nenin 3, pika 2 dhe nenin 3, të ligjit nr. 10 296, datë 08.10.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, pikën 35, 108 dhe 122, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” dhe pikën 5, germën d pikën 15, të UMB nr. 1151, datë 16.7.2007 “Për kriteret dhe procedurat e vlerësimit dhe asgjësimit të aktiveve të qëndrueshme dhe qarkulluese në sistemin e Ministrisë Brendshme”.

**3.1 - Rekomandimi:** Sektori i Financës pranë Institucionit të Prefektit të Qarkut Korçë të marrë masa, materialet për asgjësim të marrë me fletë dalje nga magazina, materialet me përbërje druri të kthej në lëndë drusore dhe të bëjë hyrje në magazinë duke i shitur si dru zjarri, si dhe materialet me përbërje metali të bëjë hyrje në magazinë duke i shitur si skrap nëpërmjet ankandit publik.

#### Në vijimësi

**4 - Gjetje nga auditimi:** Komisioni vendor, në procesverbalin e mbledhjes nuk ka regjistruar diskutimet e Prefektit. Prefekti, nuk ka thirrur në mbledhjen e komisionit drejtues të institucioneve shtetërore, që ushtrojnë veprimtari në juridiksionin e qarkut, drejtues të qeverisjes vendore, të cilët kanë lidhje dhe informacion me çështjet konkrete, që shqyrtohen si dhe në procesverbal nuk janë regjistruar diskutimet e anëtarëve të komisionit, të cilët duhet të shprehin mendimet e tyre, si dhe nuk ka përcaktuar arsyet që i bëjnë të pa vlefshëm ose absolutisht të pavlefshëm AMTP, veprim në papajtueshmëri me pikën 6 kreu III, të VKM nr. 1269, datë 17.09.2008 “Për përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe detyrat e përgjegjësive të strukturave shtetërore, të ngarkuara për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore.

**4.1 - Rekomandim:** Komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë të marrë masa, të regjistroj në procesverbalin e mbledhjes diskutimet e **Prefektit**, si dhe Prefekti, të thërras në mbledhjen e komisionit drejtues të institucioneve shtetërore, që ushtrojnë veprimtari në juridiksionin e qarkut dhe drejtues të qeverisjes vendore, të cilët kanë lidhje dhe informacion me çështjet konkrete, që shqyrtohen, si dhe të regjistrohen diskutimet e anëtarëve të komisionit, të cilët duhet të shprehin mendimet e tyre, si dhe nuk ka përcaktuar arsyet që i bëjnë të pa vlefshëm ose absolutisht të pavlefshëm AMTP.

#### Në vijimësi

**5 - Gjetje nga auditimi:** Komisioni vendorë i vlerësimit të titujve të pronësisë në **37 raste**, me sipërfaqe **84393 m<sup>2</sup>**, **nuk ka bërë kallëzim penal në organet e drejtësisë**, ndaj anëtarëve të komisioneve të ndarjes së tokës të fshatrave, pasi kanë tejkaluar kompetencat ligjore, të për pasojë, të cilat kanë sjellë, dëmtimin e rëndë të interesave të shtetit, duke ndarë tokë bujqësore mbi normën e caktuar për frymë dhe për familje të cilat nuk kanë qenë punonjës të

NB-së me datë 01.10.1992, veprim në papajtueshmëri me nenin 15, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar.

**5.1 - Rekomandim:** Komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë të marrë masa, të bëjë kallëzim penal në organet e drejtësisë, ndaj anëtarëve të komisionit të ndarjes së tokës në fshat, pasi kanë tejkaluar kompetencat ligjore, për pasojë kanë sjelle, dëmtimin e rëndë të interesave të shtetit, duke ndarë tokë bujqësore mbi normën e caktuar për frymë dhe për familje të cilat nuk kanë qenë punonjës të ish-NB-së.

#### Në vijimësi

**6 - Gjetje nga auditimi:** - Komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë në **177 raste**, nuk ka hartuar informacionin përmbledhës për verifikimet e kryera, të ballafaquara e të diskutuara me subjektin e interesuara për vendimet e marra në lidhje me vlefshmërinë ligjore të AMTP-ve, veprim në papajtueshmëri me germën a pika 6 kapitulli III, të VKM nr. 1269, datë 17.09.2008 “Për përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe detyrat e përgjegjësive të strukturave shtetërore, të ngarkuara për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar.

**6.1 - Rekomandim:** Komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë të marrë masa, të hartojë informacioni përmbledhës për verifikimet e kryera, të ballafaquara e të diskutuara me subjektin e interesuara, në lidhje me vendimin që merret për vlefshmërinë ligjore të AMTP-ve.

#### Brenda muajit Shkurt 2017

**7 - Gjetje nga auditimi:** Komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë në **37 raste**, në vendimet e hartuara nuk ka përcaktuar kalimin në pronësi shtet të tokës e cila është përfituar në kundërshtim me ligjin nga personat fizik dhe juridik, veprim në papajtueshmëri me nenin 2, 3, 4 dhe 9, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar, VKM nr. 452, datë 17.10.1992 “Për Ristrukturimin e Ndërmarrjeve Bujqësore”, të ndryshuar dhe VKM nr. 255, datë 02.08.1991 “Për kriteret e ndarjes së tokës bujqësore”, të ndryshuar.

**7.1 - Rekomandim:** Komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë të marrë masa, të përcaktoj në vendim kalimi në pronësi shtet të tokës së përfituar në kundërshtim me ligjin, nga personat fizik dhe juridik.

#### Brenda muajit Shkurt 2017

**8 - Gjetje nga auditimi:** Komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë në **37 raste**, me sipërfaqe **84393 m<sup>2</sup>**, nuk ka marrë në dorëzim tokën e liruar që përdoret në mënyrë të paligjshme nga persona fizikë dhe juridik të përfituar në kundërshtim me ligjin. Në procesverbalin e dorëzimit të hartuar ndërmjet komisionit vendor dhe Drejtorisë së Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës në Këshillin e Qarkut Korçë (DAMTP), toka e liruar është dorëzuar në mënyrë fiktive, (të parregullt) pasi nuk ka një dokument të hartuar ndërmjet komisionit vendor dhe personit fizik dhe juridik, që të vërtetoj se kjo tokë është e lirë dhe në pronësi shtet, veprim në papajtueshmëri me pikën 2 nenin 9, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar dhe pikën 4, Detyrat dhe përgjegjësive të komisionit vendor të vlerësimit të titujve të pronësisë, të VKM nr. 1269, datë 17.09.2008 “Për përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe detyrat e përgjegjësive të strukturave shtetërore, të ngarkuara për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar.

**8.1 - Rekomandim:** Komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë të marrë në dorëzim tokën e liruar nga persona të cilët e kanë përfituar në mënyrë të paligjshme, si dhe t’ia dorëzojë Drejtorisë së Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës në Qarkun Korçë (DAMTP).

#### Brenda muajit Shkurt 2017

**9 - Gjetje nga auditimi:** Komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë në **177 raste**, nuk ka bërë inventarizimin e dosjeve, si dhe nuk ka përcaktuar dorëzuesin dhe marrësin në dorëzim, veprim në papajtueshmëri me germën **dh** nenin 9, 36, 40 dhe 64, të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”.

**9.1 - Rekomandim:** Komisioni vendorë i vlerësimit të titujve të pronësisë të marrë masa, të bëjë inventarizimin e dokumentacionit në dosje, të përcaktoj sasia e fletëve që ndodhen në dosje, si dhe të përcaktohet dorëzuesi dhe marrësi në dorëzim të tyre.

#### **Brenda muajit Shkurt 2017**

**10 - Gjetje nga auditimi:** Komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë me vendim nr. 280, datë 30.01.2013, ka nxjerrë jashtë juridiksionit administrativ të komisionit pasurinë me sipërfaqe **300 m<sup>2</sup> truall** me emërtimin “**Tek shtëpia**”. Me vendim nr. 288, datë 29.03.2013, ka pushuar hetimin administrativ për pasurinë me emërtimin “**Mal**”, pasuri e cila është pa kufizime, si dhe tokën bujqësore me sipërfaqen prej **300 m<sup>2</sup>** të përfituar në kundërshtim me ligjin nuk e ka kaluar në pronësi shtet, veprim në papajtueshmëri me germën **a** neni 1, të ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991 “Për tokën”, të ndryshuar me nenin 2, 3, 4, dhe pikën 1 nenin 9, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar dhe VKM nr. 255, datë 02.08.1991 “Për kriteret e ndarjes së tokës bujqësore”, të ndryshuar.

**10.1 - Rekomandim:** Komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë të marrë masa, të rishqyrtoj vendimin nr. 280, datë 30.01.2013 për pasurinë me sipërfaqe **300 m<sup>2</sup> truall** me emërtimin “**Tek shtëpia**” dhe vendimin nr. 288, datë 29.03.2013, për pasurinë me emërtimin “**Mal**” të AMTP nr. 4443, datë 20.02.1993 dhe sipërfaqen prej **300 m<sup>2</sup>** tokë të kaloj në pronësi shtet.

#### **Brenda muajit Shkurt 2017**

**11 - Gjetje nga auditimi:** Komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë me vendim nr. 290, datë 30.04.2013, sipërfaqen **800 m<sup>2</sup>** të përfituar më shumë se norma e caktuar për frymë nuk e ka kaluar në pronësi shtet. Me vendim nr. 324, datë 20.01.2014, ka vendos pjesërisht pavlefshmërinë e AMTP nr. 14049, pa datë, duke mos u shprehur për sipërfaqe **400 m<sup>2</sup>**, pasuri e cila me datë 01.08.1991, ndodhet brenda vijës kufizuese të fshatit Zemblak në zërin kadastral “**Truall**”, veprim në papajtueshmëri me germën **a** neni 1, të ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991 “Për tokën”, të ndryshuar, me VKM nr. 255, datë 17.10.1991 “Për kriteret e ndarjes së tokës bujqësore”, të ndryshuar dhe nenin 2, 3, 4, pikën 7 nenin 8, të ligjit nr. nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar.

**11.1 - Rekomandim:** Komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë të marrë masa, të rishqyrtoj vendimin nr. 290, datë 30.04.2013 të AMTP nr. 4810, datë 20.02.1993 dhe sipërfaqen prej **800 m<sup>2</sup>** tokë të përfituar më shumë se norma për frymë dhe vendimin nr. 324, datë 20.01.2014 dhe të shprehet për sipërfaqen **400 m<sup>2</sup>**, i cili ndodhet brenda vijës kufizuese të fshatit Zemblak në zërin kadastral “**Truall**” dhe ti kaloj në pronësi shtet.

#### **Brenda muajit Shkurt 2017**

**12 - Gjetje nga auditimi:** Komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë me vendim nr. 329, datë 21.02.2014, ka deklaruar pavlefshmërinë e pjesësisht të AMTP nr. 1652, datë 27.04.1992, ndërsa nuk është shprehur për truallin me sipërfaqe prej **300 m<sup>2</sup>**, pasuri e cila me datë 01.08.1991, ndodhet brenda vijës kufizuese të fshatit Ravonik në zërin kadastral “**Truall**”. Me vendim nr. 337, datë 25.03.2014, ka vendosur deklarimin e pavlefshmërisë relative të pjesësisht të AMTP nr. 13930, datë 26.02.1994, për zërin kadastral “**Përrua**”, ndërsa komisioni vendor nuk ka filluar kontrollin e drejtpërdrejtë, të ushtruar me nismën e vet edhe për **15 pasuri të tjera të cilat janë ndarë në zërin kadastral “Përrua”**, veprim në papajtueshmëri me germën **a** neni 1, të ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991 “Për tokën”, të ndryshuar me nenin 2, 3, 4, germën **b** pikën 2, neni 7 dhe pikën 1 nenin 9, të ligjit nr. 9948,

datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar dhe VKM nr. 255, datë 02.08.1991 “Për kriteret e ndarjes së tokës bujqësore”, të ndryshuar.

**12.1 - Rekomandim:** Komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë të marrë masa, të rishqyrtoj vendimin nr. 329, datë 21.02.2014, dhe sipërfaqen **300 m<sup>2</sup>**, i cili me datë 01.08.1991, ndodhet brenda vijës kufizuese të fshatit Ravonik në zërin kadastral “Truall” dhe të filloj kontrollin e drejtpërdrejtë, të ushtruar me nismën e vet, edhe për **15 pasuri** të ndara në zërin kadastral “Përrua”.

#### **Brenda muajit Shkurt 2017**

**13 - Gjetje nga auditimi:** Komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë me vendim nr. 384, datë 26.02.2015, ka deklaruar përfundimin e procedimit administrativ për shkak të pamundësisë të zhvillimit të mëtejshëm të procedurës hetimore për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të pasurive rreshti **2, 4, 5, 6, 7, 8**, të AMTP nr. 6007, datë 20.05.1993 lëshuar në emër të z. P.P. fshati Voskopojë.

Me vendim nr. 401, datë 29.06.2015, ka deklaruar përfundimin e procedimit administrativ për shkak të pamundësisë të zhvillimit të mëtejshëm të procedurës hetimore për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të pasurive rreshti **2, 3, 4, 5, 6**, të AMTP nr. 5981, datë 08.05.1993 lëshuar në emër të Th.S, fshati Voskopojë. Përfundimi nga hetimi administrativ i pasurive është bërë pasi komisioni vendor nuk ka mbledhur informacionin e duhur nga institucionet vendore, duke mos zbatuar procedurën ligjore për të cilën është ngarkuar të kryej, veprim në papajtueshmëri me nenin 4, germën **b** pikën 2 neni 7 dhe paragrafi **i** germa **a** pikën 1 neni 9, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar dhe germën **c** pika 1, Detyrat dhe përgjegjësitë e komisionit vendor të vlerësimit të titujve të pronësisë, të VKM nr. 1269, datë 17.09.2008 “Për përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe detyrat e përgjegjësitë e strukturave shtetërore, të ngarkuara për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar.

**13.1 - Rekomandim:** Komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë të marrë masa, të rishqyrtoj vendimin nr. 384, datë 26.02.2015, për vlefshmërinë ligjore të pasurive rreshti **2, 4, 5, 6, 7, 8**, të AMTP nr. 6007, datë 20.05.1993, lëshuar në emër të z. P.P. dhe vendimin nr. 401, datë 29.06.2015, për vlefshmërinë ligjore të pasurive rreshti **2, 3, 4, 5, 6**, të AMTP nr. 5981, datë 08.05.1993 lëshuar në emër të z. Th.S, fshati Voskopojë.

#### **Brenda muajit Shkurt 2017**

**14 - Gjetje nga auditimi:** Komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë me vendim nr. 297, datë 28.06.2013, ka vendosur mos shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të AMTP **pa numër** datë 27.05.1997, lëshuar në emër të A.B. me sipërfaqe **8900 m<sup>2</sup>**, ndërsa ai është larguar nga ish-NB Bilisht, 4 muaj para datës 01.10.1992, duke përfituar tokë bujqësore në kundërshtim me ligjin. Komisioni vendor me vendim nr. 298, datë 28.06.2013, ka vendosur mos shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të AMTP 344, datë 18.10.1990, lëshuar në emër z. F.K. me sipërfaqe **120 m<sup>2</sup>**, pasi është larguar nga ish-NB Bilisht, 15 ditë para datës 01.10.1992 dhe ka përfituar tokë në kundërshtim me ligjin, veprim në papajtueshmëri me pikën 1 neni 9, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar.

**14.1 - Rekomandim:** Komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë të marrë masa, të rishqyrtoj vendimin nr. 297, datë 28.06.2013, për vlefshmërinë ligjore të AMTP **pa numër** dhe datë 27.05.1997 me sipërfaqe **8900 m<sup>2</sup>** dhe vendimin nr. 298, datë 28.06.2013 dhe të shqyrtoj vlefshmërinë ligjore të AMT P 344, datë 18.10.1990, me sipërfaqe **120 m<sup>2</sup>** dhe të bëjë kalimin e tyre në pronësi shtet.

#### **Brenda muajit Shkurt 2017**

**15 - Gjetje nga auditimi:** Komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë me vendim nr. 299, datë 28.06.2013, ka vendosur mos shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të AMTP **pa**

**numër**, datë 17.10.1996, me sipërfaqe **14970 m<sup>2</sup>**, ish-NB Bilisht. Komisioni vendor me vendim nr. 300, datë 28.06.2013, ka vendosur mos shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të AMTP **pa numër**, datë 17.10.1996, me sipërfaqe **15670 m<sup>2</sup>**, ish-NB Bilisht. Gjatë hetimit administrativ nuk janë zbatuar procedurat e përcaktuara në kreun A pika 1/2, të UKM nr. 2, datë 13.01.2010 “Për mënyrën e verifikimit apo shqyrtimit të vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore, nga komisioni vendor i titujve të pronësisë, kur këtë e kërkojnë individ a institucione”, veprim në papajtueshmëri me pikën 1 neni 9, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar.

**15.1 - Rekomandim:** Komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë të marrë masa, të rishqyrtoj vendimin nr. 299, datë 28.06.2013, për vlefshmërinë ligjore të AMTP pa numër, datë 17.10.1996, me sipërfaqe **14970 m<sup>2</sup>** dhe vendimin nr. 300, datë 28.06.2013, për vlefshmërinë ligjore të AMTP pa numër, datë 17.10.1996, me sipërfaqe **15670 m<sup>2</sup>**, duke zbatuar procedurat e përcaktuara në duke zbatuar procedurat e përcaktuara në kreun A pika 1/2, të UKM nr. 2, datë 13.01.2010 “Për mënyrën e verifikimit apo shqyrtimit të vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore.

#### **Brenda muajit Shkurt 2017**

**16 - Gjetje nga auditimi:** Komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë me vendim nr. 301, datë 10.07.2013, ka vendosur mos shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të AMTP nr. 803, datë 20.10.2000, me sipërfaqe **1100 m<sup>2</sup>** dhe vendimin nr. 305, datë 10.07.2013, për vlefshmërinë ligjore të AMTP nr. 170, datë 18.06.1993, me sipërfaqe **4500 m<sup>2</sup>**, ish-NB Korça. Komisioni vendor në të dy rastet duhet të kishte vendosur pavlefshmërinë absolute të AMTP nr. 170, datë 18.06.1993 dhe AMTP nr. 803, datë 20.10.2000, pasi Këshilli i Qarkut Korçë ka konfirmuar se parcela kadastrale 132/1, ka hyrë brenda vijave kufizuese të qytetit të Korçës me vendim nr. 3, datë 04.02.1994, të KRRTRSH-së, veprim në papajtueshmëri me pikën 1 neni 9, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar.

**16.1 - Rekomandim:** Komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë të marrë masa, të rishqyrtoj vendimin nr. 301, datë 10.07.2013, për vlefshmërinë ligjore të AMTP nr. 803, datë 20.10.2000, me sipërfaqe **1100 m<sup>2</sup>** dhe vendimin nr. 305, datë 10.07.2013, për vlefshmërinë ligjore të AMTP nr. 170, datë 18.06.1993, me sipërfaqe **4500 m<sup>2</sup>**, duke zbatuar vendimin nr. 3, datë 04.02.1994, të KRRTRSH-së dhe kalimin në pronësi shtet.

#### **Brenda muajit Shkurt 2017**

**17-Gjetje nga auditimi:** Komisioni vendor me vendim nr. 307, datë 10.07.2013, ka vendosur mos shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të AMTP nr. 667, datë 28.06.1999, me sipërfaqe **15000 m<sup>2</sup>** dhe vendimin nr. 308, datë 10.07.2013, për AMTP nr. 698, datë 17.06.1996, me sipërfaqe **10000 m<sup>2</sup>**, ish-NB Korça. Komisioni vendor në të dy raste duhet të kishte vendosur pavlefshmërinë absolute të AMTP nr. 698, datë 17.06.1996, dhe të AMTP nr. 698, datë 17.06.1996, pasi Këshilli i Qarkut Korçë ka konfirmuar se parcela kadastrale 137/6, ka hyrë brenda vijave kufizuese të qytetit të Korçës me vendim nr. 3, datë 04.02.1994, të KRRTRSH-së, veprim në papajtueshmëri me pikën 1 neni 9, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar.

**17.1 - Rekomandim:** Komisioni vendor të marrë masa, të rishqyrtoj vendimin nr. 307, datë 10.07.2013, për vlefshmërinë ligjore të AMTP nr. 667, datë 28.06.1999, me sipërfaqe **15000 m<sup>2</sup>** dhe vendimin nr. 308, datë 10.07.2013, për vlefshmërinë ligjore të AMTP nr. 698, datë 17.06.1996, me sipërfaqe **10000 m<sup>2</sup>**, duke zbatuar vendimin nr. 3, datë 04.02.1994, të KRRTRSH-së pasi parcela ka hyrë brenda vijave kufizuese të qytetit të Korçës dhe kalimin në pronësi shtet.

#### **Brenda muajit Shkurt 2017**

**18 - Gjetje nga auditimi:** Komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë me vendim nr. 358, datë 30.09.2014, ka vendosur mos shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të AMTP nr. 38, datë 11.08.2000, me sipërfaqe **12000 m<sup>2</sup>** dhe me vendim nr. 341, datë 16.05.2014, ka vendosur mos shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të AMTP nr. 169, datë 28.06.1996, me sipërfaqe **3000 m<sup>2</sup>**, ish-NB Korça. Komisioni vendor në të dy raste duhet të kishte vendosur pavlefshmërinë absolute të AMTP nr. 698, datë 17.06.1996 dhe të AMTP nr. 698, datë 17.06.1996, pasi Këshilli i Qarkut Korçë ka konfirmuar se parcela kadastrale 9/57 dhe 9/11, me vendim nr. 3, datë 04.02.1994, të KRRTRSH-së ka hyrë brenda vijave kufizuese të qytetit të Korçës, veprim në papajtueshmëri me pikën 1 neni 9, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar.

**18.1 - Rekomandim:** Komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë të marrë masa, të rishqyrtoj vendimin nr. 358, datë 30.09.2014, mbi vlefshmërinë ligjore të AMTP nr. 38, datë 11.08.2000, me sipërfaqe **12000 m<sup>2</sup>** dhe vendimin nr. 341, datë 16.05.2014, për vlefshmërinë ligjore të AMTP nr. 169, datë 28.06.1996 dhe të AMTP nr. 169, datë 28.06.1996, me sipërfaqe **3000 m<sup>2</sup>**, duke zbatuar vendimin nr. 3, datë 04.02.1994, të KRRTRSH-së pasi parcela ka hyrë brenda vijave kufizuese të qytetit të Korçës dhe kalimin në pronësi shtet.

#### **Brenda muajit Shkurt 2017**

**19 - Gjetje nga auditimi:** Komisioni vendor për kontrollë të drejtpërdrejta, të ushtruara me nismën e vet, për tokat e ish-NB dhe zonat me përparësi turizmit për vitin 2013 nuk janë kontrolluar **5585** AMTP, për vitin 2014 nuk janë kontrolluar **4247** AMTP, për vitin 2015 nuk janë kontrolluar **4070** AMTP dhe për periudhën Janar-Qershor 2016 nuk janë kontrolluar **2065** AMTP, veprim në papajtueshmëri me nenin 7, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar.

**19.1 - Rekomandim:** Komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë të marrë masa, të zbatoj programin vjetorë për kontrollët e drejtpërdrejta, të ushtruar me nismën e vet, dhe të miratuar nga Komisioni Qeveritar i Tokës Tiranë.

#### **Brenda muajit Shkurt 2017**

**20- Gjetje nga auditimi:** Komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë në **15 raste**, ka marrë vendime për deklarimin e përfundimit të procedimit administrativ për shkak të pamundësive të zhvillimit të mëtejshëm të procedurës hetimore për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të AMTP, veprim në papajtueshmëri me nenin 9, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore” të ndryshuar, VKM nr. 1269, datë 17.09.2008 “Për përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe detyrat e përgjegjësitë e strukturave shtetërore, të ngarkuara për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar.

**20.1 - Rekomandim:** Prefekti i Qarkut Korçë dhe KV (komisioni vendor) të marrin masat për rishqyrtim të 15 dosjeve për të cilat ka deklaruar përfundimin e procedimit administrativ duke marr një vendim në përmbushje të detyrës funksionale në zbatim të tagrit ligjor të përcaktuar nga neni 9 e në vijim të ligji nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore” të ndryshuar.

#### **Brenda muajit Shkurt 2017**

**21 - Gjetje nga auditimi:** Komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë në **3 raste**, me vendim nr. 325, datë 20.01.2014, ka rrezuar kërkesën për korrigjimin e AMTP nr. 118, **pa datë** në emër të z. M.U me numër Kadastral 1235/6, pasi DAMT Qarku Korçë, konfirmon zërin kadastral tokë pafrytshme “P. F”, me vendim nr. 330, datë 21.02.2014, ka rrezuar kërkesën për korrigjim të AMTP nr. 134, **pa datë** në emër të z. M.U me numër Kadastral 1235/5, pasi DAMT Qarku Korçë, konfirmon zërin kadastral tokë pafrytshme “P. F” dhe me

vendim nr. 388, datë 13.03.2015, ka rrezuar kërkesën për korrigjim të AMTP nr. 326, pa datë në emër të z. A.U, me nr. Kadastral 1235/4, pasi DAMT Qarku Korçë, konfirmon zërin kadastral tokë pafrytshme “P. F”, veprim në papajtueshmëri me nenin 9, pika 2, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar.

**21.1 - Rekomandim:** Komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë të marrë masa, të rishqyrtoj vendim nr. 325, datë 20.01.2014, për korrigjimin e AMTP nr. 118, pa datë në emër të M.U, vendimin nr. 330, datë 21.02.2014, për korrigjim e AMTP nr. 134, pa datë në emër të MU dhe vendimin nr. 388, datë 13.03.2015, për korrigjim e AMTP nr. 326, pa datë në emër të A.U pasi DAMT-Qarkut Korçë konfirmon zërin kadastral tokë pafrytshme “P. F”.

**Brenda muajit Shkurt 2017**

**22 - Gjetje nga auditimi:** Komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë në një rast, në vendimin nr. 414, datë 22.10.2015, sipërfaqe prej **205 m<sup>2</sup> tokë** bujqësore nuk e ka kaluar në pronësi shtet, pasi z. L.Sh. ka refuzuar blerjen e tokës të përfiturar mbi normën për frymë të fshatit Libonik, veprime në papajtueshmëri me nenin 9, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar dhe VKM nr. 1269, datë 17.09.2008 “Për përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe detyrat e përgjegjësitë e strukturave shtetërore, të ngarkuara për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar.

**22.1 - Rekomandim:** Komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë të marrë masa, të rishqyrtoj vendim nr. 414, datë 22.10.2015, me sipërfaqe 205 m<sup>2</sup> tokë dhe kalimin në pronësi shtet, pasi L.Sh. nuk ka blerë tokën e përfiturar mbi normën për frymë në fshatin Libonik.

**Brenda muajit Shkurt 2017**

**23 - Gjetje nga auditimi:** Komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë në një rast, me vendim 360, datë 30.09.2014, ka plotësuar AMTP me sipërfaqe **4486 m<sup>2</sup>**, lëshuar në emër të z. F.D. pasi në dosje mungon dokumentacioni i përcaktuar në pikën 4, 5 dhe 7 të VKM nr 224/2009, veprim në papajtueshmëri me VKM nr 224, datë 19.02.2009 “Për procedurat e krijimit të Akteve të marrjes së tokës bujqësore në pronësi, si pasojë e korrigjimeve të kryera nga Komisioni Vendorë i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë”.

**23.1 - Rekomandim:** Komisioni vendorë i vlerësimit të titujve të pronësisë të marrë masa, të plotësoj me dokumentacionin tekniko ligjor dosjen e vendimit 360, datë 30.09.2014, me sipërfaqe 4486 m<sup>2</sup>, për të cilën është lëshuar AMTP në emër të z. F.D.

**Brenda muajit Shkurt 2017**

## **B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI**

Mbështetur në nenet 98-102 të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, pikën 93 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, **nga ana e titullarit të njësisë publike**, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore) duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit, shpenzime të cilat vijnë në mospërputhje me 3 E-të (ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet). **Nëpunësi zbatues** të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabile përfundimtare me qëllim shpërblimin e dëmit në **vlerën 635,215 lekë, si më poshtë:**

**1 - Gjetje nga auditimi:** Seksioni i Financës pranë Prefektit të Qarkut Korçë, për vitin 2015 deri me 30.06.2016, ka furnizuar me **2200 litra naftë me vlerë 368,673 lekë**, z. A.K. me detyrë Nënprefekt i Rrethit Devoll dhe ka furnizuar me **1600 litra naftë me vlerë 266,542 lekë**, z. L.M. me detyrë Nënprefekt i Rrethit Pogradec.

Me Urdhër të Kryeministrit, Nënprefektit të Rrethit Devoll dhe Pogradec u janë hequr mjetet e transportit për administratën, e si pasojë naftën e marrë Nënprefektët e kanë përdorur për



mjetet e tyre personale, veprim në papajtueshmëri me nenin 127, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe germën f, nenin 12, të ligji 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiarë dhe kontrollin”.

**1.1 - Rekomandimi:** Sektori i Financës pranë Institucionit të Prefektit të Qarkut Korçë, të marrë masa, të ndjek në rrugë ligjore dhe administrative arkëtimin e shumës **368,673 lekë**, nga z. A.K. me detyrë Nënprefekt i Rrethit Devoll dhe shumën **266,542 lekë**, nga z. L.M. me detyrë Nënprefekt i Rrethit Pogradec.

**Brenda muajit Shkurt 2017**

## **D. MASA DISIPLINORE:**

### **D-I. Për punonjësit që janë pjesë e shërbimit civil.**

Bazuar në nenin 15 shkronja (c), të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe mbështetur në nenin 58 “llojet e masave disiplinore” shkronjat (b dhe c), të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar me ligjin nr. 178/2014 datë 18.12.2014; Kreu I- Organet Disiplinore, pikat 3 dhe 10, të VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil” i rekomandojmë Titullarit të Institucionit që të klasifikojë shkeljet e konstatuara dhe **ti kërkojë** Komisionit disiplinor (KD), pranë Institucionit të Prefektit Qarkut Korçë, të fillojnë ecurinë disiplinore për marrjen e masës disiplinore nga “Mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj” deri në “Pezullim nga e drejta për ngritjen në detyrë përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”, parashikuar në nenin 58 shkronja (b) dhe (c), për **4 punonjësit, si më poshtë:**

#### **1 - znj. M.F. me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse;**

- Mos bërjen hyrje në magazinë të materialeve jashtë përdorimit, veprim në papajtueshmëri me pikën 109, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, të ndryshuar dhe pikën 5, të UMB nr. 1151, datë 16.7.2007 “Për kriteret dhe procedurat e vlerësimit dhe asgjësimit të aktiveve të qëndrueshme dhe qarkulluese në sistemin e Ministrisë Brendshme”.

- Mos kërkimin ndaj komisionit të asgjësimit për marrjen e materialeve për asgjësim me fletë dalje nga magazine, veprim në papajtueshmëri me nenin 3, pika 2 dhe nenin 3, të ligjit nr. 10296, datë 08.10.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, pikën 108 dhe 122, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, të ndryshuar dhe pikën 5, të UMB nr. 1151, datë 16.7.2007 “Për kriteret dhe procedurat e vlerësimit dhe asgjësimit të aktiveve të qëndrueshme dhe qarkulluese në sistemin e Ministrisë Brendshme”.

- Mos respektimin e procedurave ligjore mbi shpenzimin e karburantit me vlerë **635,215 lekë**, përdorur nga Nënprefekti i Rrethit Devoll dhe Pogradec, veprim në papajtueshmëri me nenin 127, të ligjit nr 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe germën f, neni 12, të ligji 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiarë dhe kontrollin”, të ndryshuar.

#### **2 - z. T.Xh. me detyrë specialist Sektorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse;**

- Mos bërja hyrje në magazinë të materialeve jashtë përdorimit, veprim në papajtueshmëri me pikën 109, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, të ndryshuar dhe pikën 5, të UMB nr. 1151, datë 16.7.2007 “Për kriteret dhe procedurat e vlerësimit dhe asgjësimit të aktiveve të qëndrueshme dhe qarkulluese në sistemin e Ministrisë Brendshme”.

- Mos kërkimin ndaj komisionit të asgjësimit për marrjen e materialeve për asgjësim me fletë dalje nga magazine, veprim në papajtueshmëri me nenin 3, pika 2 dhe nenin 3, të ligjit nr. 10

296, datë 08.10.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, pikën 108 dhe 122, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, të ndryshuar dhe pikën 5, të UMB nr. 1151, datë 16.7.2007 “Për kriteret dhe procedurat e vlerësimit dhe asgjësimit të aktiveve të qëndrueshme dhe qarkulluese në sistemin e Ministrisë Brendshme”.

### **3 - z. D.K. me detyrë Përgjegjës i Sektorit Juridik;**

- Mos respektimin e procedurave ligjore mbi shpenzimin e karburantit me vlerë **635,215 lekë** (e përdorur nga Nënprefekti i Rrethit Devoll dhe Pogradec, veprim në papajtueshmëri me nenin 127, të ligjit nr 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe germën **f**, neni 12, të ligji 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiarë dhe kontrollin”, të ndryshuar.

### **4. zj. F.R. me detyrë specialiste në Sektorin e Kontrollit Vendor, në cilësinë e anëtarit të KVO;**

- Mos respektimin e procedurave ligjore në tenderin e vitit 2013 me objekt “*Shërbimi i rojeve dhe sigurisë fizike*”, me fond limit 1,147,000 duke kualifikuar ofertën e cila nuk plotëson kriteret për kualifikim, veprim në kundërshtim me nenet 46, 53 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe kreu V, të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

### **D-II. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës.**

Mbështetur në nenet 37, 141, 153, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar me ligjin nr. 8085, datë 13.03.1996 dhe nr. 9125, datë 29.07.2003, ligjin nr. nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore të ndryshuar”, **i rekomandojmë Prefektit Qarkut Korçë**, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

### **“Zgjidhjen e kontratës së punës”, për 6 punonjësit e mëposhtëm:**

- 1. z. S.K.** me detyrë Drejtori komisionit vendor, për shkelje në 37 raste;
- 2. z. H.G.** me detyrë specialist në komisionin vendor, për shkelje në 16 raste;
- 3. z. E.R.** me detyrë specialist në komisionin vendor, për shkelje në 4 raste;
- 4. znj. O.G.** me detyrë specialiste në komisionin vendor, për shkelje në 8 raste;
- 5. z. J.D.** me detyrë specialist në komisionin vendor, për shkelje në 3 raste;
- 6. znj. L.S.** me detyrë specialiste në komisionin vendor. për shkelje në 1 raste.

Për shkeljet e mëposhtme:

- Për moszbatim të kërkesave të nenit 2, 3, 4, 7, 8, 9, 13 dhe 15, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar, VKM nr. 1269, datë 17.09.2008 “Për përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe detyrat e përgjegjësive të strukturave shtetërore, të ngarkuara për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar, VKM nr. 224, datë 19.02.2009 “Për procedurat e krijimit të Akteve të marrjes së tokës bujqësore në pronësi, si pasojë e korrigjimeve të kryera nga Komisioni Vendorë i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë”, germën **d**, të nenit 66, të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, germën **dh** nenin 9, 36, 40 dhe 64, të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”.

- Për të metat e mangësi të konstatuara, në zbatimin e procedurave ligjore e nënligjore në marrjen e vendimeve dhe veprimeve të tjera të komisionit vendor për vlerësimin ligjor të titujve të pronësisë, sipas trajtimit në procesverbale dhe në kapitujt përkatës të Raportit

Përfundimtar të Auditimit të paraqitur për Institucionin e Prefektit të Qarkut Korçë, si më poshtë:

- **Për mos përcaktimin në vendim në 37 raste**, mbi kalimi në pronësi të shtetit për tokat e përfiturar në kundërshtim me ligjin nga persona fizik dhe juridik, veprim në papajtueshmëri me nenin 2, 3, 4 dhe 9, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar.

- **Për mos kallëzimin penal në organet e drejtësisë, në 37 raste** me sipërfaqe **84393 m<sup>2</sup>**, ndaj komisioneve të ndarjes tokës në fshat dhe të Rrethit Korçë, **të cilët ka tejkaluar kompetencat ligjore, duke ndarë tokë bujqësore më shumë se norma për frymë, që kanë sjellë, për pasojë, dëmtimin e rëndë të interesave të shtetit**, veprim në papajtueshmëri me nenin 15, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar.

- **Për dorëzimin e tokave të liruara në mënyrë fiktive në 37 raste**, në DAMT së Qarkut Korçë, pas toka vazhdon të përdoret nga persona të cilët e kanë përfiturar në mënyrë të paligjshme, veprim në papajtueshmëri me pikën 2 nenin 9, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar dhe pikën 4, Detyrat dhe përgjegjësitë e komisionit vendor të vlerësimit të titujve të pronësisë, të VKM nr. 1269, datë 17.09.2008 “Për përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe detyrat e përgjegjësitë e strukturave shtetërore, të ngarkuara për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar

- **Për mos marrjen e vendimit për truallin me sipërfaqe 300 m<sup>2</sup>**, për ta kaluar në pronësi shtet, pasi kjo pasuri është ndarë në kundërshtim me ligjin nr. 7501, datë 19.07.1991 “Për tokën”, të ndryshuar dhe pikën 1 nenin 9, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar.

- **Për pushimin e hetimit administrativ për pasurinë me emërtimin “Mal”** me sipërfaqe 800 m<sup>2</sup>, pasuri e cila është pa kufizime dhe për pasurinë me emërtimin **“Gjambi 4”**, me sipërfaqe 400 m<sup>2</sup>, pasi DAMT në Qarkun Korçë dhe institucionet e treta konfirmojnë se është e pamundur vendndodhja e pasurisë dhe nuk kanë të dhëna, veprim në papajtueshmëri me pikën 7 nenin 8, të ligjit nr. nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar.

- **Për llogaritjen e sipërfaqes së tokës bujqësore më pak 800 m<sup>2</sup>** dhe mos kalimin e saj në pronësi të shtetit, veprim në papajtueshmëri me nenin 9, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar.

- **Për mos marrjen e vendimit për truallin me sipërfaqe 400 m<sup>2</sup>**, pasi me datë 01.10.1992, kjo pasuri ndodhet brenda vijës kufizuese të fshatit Zemblak në zërin kadastral **“Truall”**, si pasoj komisioni vendor ka punuar me dy standarde, pasi në disa raste trualli që ndodhet brenda vijave kufizuese të fshatit e ka kaluar në pronësi shtet, veprim në papajtueshmëri me pikën 1 neni 9, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar.

- **Për mos marrjen e vendimit për truallin me sipërfaqe 300 m<sup>2</sup>**, pasi me datë 01.08.1991, ndodhet brenda vijës kufizuese të fshatit Ravonik në zërin kadastral **“Truall”**, veprim në papajtueshmëri me pikën 1 neni 9, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar.

- Për mos fillimin e kontrollit të drejtpërdrejtë, të ushtruar me nismën e vet, për të gjitha pasuritë që janë ndarë në zërin kadastral **“Përrua”**, pasi kemi të bëjmë me toka të ish-NB-së, që është detyruese për komisionin vendor dhe që tregon për një punë selektive, veprim në papajtueshmëri me germën b pikën 2, neni 7, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar.

- **Për mos zbatimin e vendimit të KRRTRSH-së nr. 3, datë 04.02.1994**, për përcaktimin e vijave kufizuese të qytetit të Korçës, pasi Këshilli i Qarkut Korçë:

Me shkresë nr. 1528/1, datë 19.11.2012, konfirmon se pasuria nr. 10/64 ndodhet në parcelën kadastrale 132/1 me nomenklaturë K-34-126-(41), në zërin kadastral “Arë” me sipërfaqe 28300 m<sup>2</sup>, parcela kadastrale ka hyrë brenda vijave kufizuese të qytetit të Korçës,

Me shkresë nr. 2255/1, datë 03.12.2010, konfirmon se pasuria nr. 29/15/1 ndodhet në parcelën kadastrale 9/1 me nomenklaturë K-34-126-(26), në zërin kadastral “Arë” me sipërfaqe 110600 m<sup>2</sup>, parcela kadastrale ka hyrë brenda vijave kufizuese të qytetit të Korçës,

Me shkresë nr. 532, datë 05.04.2011, konfirmon se pasuria nr. 108/3 ndodhet në parcelën kadastrale 108 me nomenklaturë K-34-126-(41), në zërin kadastral “Arë” me sipërfaqe 64200 m<sup>2</sup>, parcela kadastrale ka hyrë brenda vijave kufizuese të qytetit të Korçës,

Me shkresë nr. 584, datë 29.03.2010, konfirmon se pasuria nr. 137/6 ndodhet në parcelën kadastrale 137/1 me nomenklaturë K-34-126-(41), në zërin kadastral “Arë” me sipërfaqe 163200 m<sup>2</sup>, parcela kadastrale ka hyrë brenda vijave kufizuese të qytetit të Korçës,

Me shkresë nr. 1589, datë 17.12.2013, konfirmon se pasuria nr. 9/53 dhe nr. 9/58 ndodhet në parcelën kadastrale 22 me nomenklaturë K-34-126-(25), në zërin kadastral “Arë” me sipërfaqe 91200 m<sup>2</sup> dhe pasuria nr. 9/57, ndodhet në parcelën kadastrale 60/1 me nomenklaturë K-34-126-(25), në zërin kadastral “Arë” me sipërfaqe 54300 m<sup>2</sup>, parcela kadastrale ka hyrë brenda vijave kufizuese të qytetit të Korçës.

Me shkresë nr. 456/1, datë 29.03.2013, konfirmon se pasuria nr. 29/14 dhe nr. 29/14/1 ndodhet në parcelën kadastrale 9/11 me nomenklaturë K-34-126-(26), në zërin kadastral “Arë” me sipërfaqe 11060 m<sup>2</sup>, parcela kadastrale ka hyrë brenda vijave kufizuese të qytetit të Korçës,

Veprime në papajtueshmëri me pikën 1 neni 9, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshua.

**- Për kapërcim të tagrit në 15 raste**, duke marrë vendime mbi deklarimin e përfundimit të procedimit administrativ për shkak të pamundësive të zhvillimit të mëtejshëm të procedurës hetimore, pasi ligji KV nuk i njeh të drejtën e përfundimit të procedimit administrativ pa një vendimmarrje, veprim në papajtueshmëri me nenin 9, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar dhe VKM nr. 1269, datë 17.09.2008 “Për përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe detyrat e përgjegjësitë e strukturave shtetërore, të ngarkuara për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar.

**-Për mos marrje të vendimit për heqjen e sipërfaqes të përfituar më shumë prej 205 m<sup>2</sup>** veprime në papajtueshmëri me nenin 9, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar dhe VKM nr. 1269, datë 17.09.2008 “Për përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe detyrat e përgjegjësitë e strukturave shtetërore, të ngarkuara për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar.

**- Për mos veprim në 2 raste, në lidhje me zërin kadastral “P-F”**, pasi nuk ka qenë objekt i ligjit për tu ndarë nga komisioni i ndarjes së tokës në fshat, veprim në papajtueshmëri me nenin 9, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar, VKM nr. 1269, datë 17.09.2008 “Për përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe detyrat e përgjegjësitë e strukturave shtetërore, të ngarkuara për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar.

## **E. KALLËZIM PENAL**

I. Bazuar në nenin 281, të Ligjit nr. 7905, datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Ligjin nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar, VKM nr. 1269, datë 17.09.2008 “Për përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe detyrat e përgjegjësitë e strukturave shtetërore, të ngarkuara për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar dhe VKM nr. 224, datë 19.02.2009 “Për procedurat e krijimit të Akteve të marrjes së tokës bujqësore në pronësi, si pasojë e korrigjimeve të kryera nga Komisioni Vendorë i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë”, bëjmë kallëzim penal për:

1. **z. S.K.** me detyrë Drejtori i Komisionit Vendor,
2. **z. H.G.** me detyrë specialist në komisionin vendor,
3. **z. E.R.** me detyrë specialist në komisionin vendor,
4. **znj. O.G.** me detyrë specialiste në komisionin vendor,
5. **z. J.D.** me detyrë specialist në komisionin vendor dhe
6. **znj. L.S.** me detyrë specialiste në komisionin vendor.
7. **E.Ç.** me detyrë ish-specialist në komisionin vendor larguar nga puna me datë 18.04.2014,
8. **G.H.** me detyrë ish-specialiste në komisionin vendor larguar nga puna me datë 06.01.2014.

pasi kanë kryer veprime të kundërligjshme të cilat referuar përmbajtjes së dispozitës penale, neni 248 të Kodit Penal, mbartin elementët e veprës penale të “*Shpërdorimit të detyrës*” dhe janë në kundërshtim me nenin 2, 3, 4, 7, 8, 9, 13 dhe 15, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar, VKM nr. 1269, datë 17.09.2008 “Për përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe detyrat e përgjegjësitë e strukturave shtetërore, të ngarkuara për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar, VKM nr. 224, datë 19.02.2009 “Për procedurat e krijimit të Akteve të marrjes së tokës bujqësore në pronësi, si pasojë e korrigjimeve të kryera nga Komisioni Vendorë i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë”, germën d, të nenit 66, të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, germën **dh** nenin 9, 36, 40 dhe 64, të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”.

***Shënim: Bazuar në nenin 22 të ligjit nr. 8457, datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar”, i ndryshuar, Kallëzimi Penal nuk publikohet.***

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor dhe Departamenti Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës.

**Bujar LESKAJ**

**K R Y E T A R**